



Public Health
England

NHS

Çfarë mund të prisni pas vaksinimit tuaj **COVID-19** vaccination

Informacion për njerëzit
që sapo kanë bërë
vaksinimin e tyre COVID-19

Zbuloni më shumë në nhs.uk/CovidVaccine

Përmbajtja

Cilat janë efektet anësore?

A mund ta kap COVID-19 nga vaksinat?

Kur mund të kthehem në aktivitetet e përditshme?

Çfarë të bëj më tej?

Çfarë duhet të bëj nëse nuk jam mirë kur të jetë takimi im i radhës?

A do të më mbrojë vakcina?

Çfarë mund të bëj pasi të kem bërë vaksinën?

Ju lutemi lexoni broshurën e informacionit të produktit për më shumë detaje mbi vaksinën tuaj, përfshirë efektet anësore të mundshme, duke kërkuar Kartën e Verdhë të Koronavirusit.

Ju, gjithashtu, mund të raportoni efekte anësore të dyshuara në të njëjtën faqe në internet, ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card.



coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk

Personave që janë më të rrezikuar nga ndërlikimet e COVID-19, u ofrohet vaksinimi COVID-19.

Kjo broshurë ju tregon se çfarë të prisni pasi të keni bërë vaksinimin tuaj. Nëse keni nevojë për një dozë të dytë të vaksinës, sigurohuni që të caktoni takimin tuaj të rradhës.

Pas rishikimit të hollësishëm të studimeve të mëdha të sigurisë dhe efektivitetit, Agjencia Rregulative e Barnave dhe Produkteve të Kujdesit Shëndetësor (MHRA) tani ka aprovuar disa lloje të ndryshme të vaksinave COVID-19 për përdorim në MB.

Një grup i pavarur ekspertësh ka rekomanduar që NHS t'i ofrojë këto vakcina për ata që rrezikojnë të preken nga infeksioni dhe të pësojnë komplikime serioze.

Tani që ka më shumë vakcina të disponueshme, ne po ofrojmë mbrojtje për të gjithë të rriturit sipas rrezikut.

Cilat janë efektet anësore?

Si të gjitha ilaçet, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica e këtyre janë të lehta dhe afatshkurtra, dhe jo të gjithë i kanë këto. Edhe nëse keni simptoma pas dozës së parë, sërish duhet të bëni dozën e dytë. Megjithëse mund të merrni pak mbrojtje nga doza e parë, marrja e dozave të rekomanduara do t'ju japë mbrojtjen më të mirë kundër virusit.

Efektet anësore shumë të zakonshme në ditën e parë ose të dytë përfshijnë:

- të paturit një ndjenjë dhimbje, të rëndë dhe butësi në krahun ku keni bërë injeksionin tuaj
- ndjenjë lodhjeje
- dhimbje koke, dhimbje dhe të dridhura

Ju, gjithashtu, mund të keni simptoma të ngjashme me gripin, me episode ethesh dhe të dridhurash për një ose dy ditë. Sidoqoftë, një temperaturë e lartë mund të tregojë gjithashtu, që keni COVID-19 ose një infeksion tjetër (shihni këshillat në faqen 5). Mund të pushoni dhe të merrni dozën normale të paracetamolit (ndiqni këshillat në paketim) për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë.

Një efekt anësor i pazakontë janë gjëndrat e ënjtura në sqetull ose qafë në të njëjtën anë me krahun ku keni bërë vaksinën. Kjo mund të zgjasë për rreth 10 ditë, por nëse zgjat më shumë, vizitoni mjekun tuaj. Nëse do të bëni një mamografi brenda disa javësh pas vaksinës, atëherë duhet ta përmendni kur të keni takimin.

Çfarë duhet të bëj nëse shqetësohem për simptomat e mia?

Këto simptoma normalisht zgjasin më pak se një javë. Nëse simptomat tuaja duket se përkeqësohen ose nëse shqetësoheni, telefononi NHS 111. Nëse kërkonti këshillë nga një mjek ose infermier, sigurohuni që t'u tregoni atyre rreth vaksinimit tuaj (tregojini kartën e vaksinimit) në mënyrë që ata t'ju vlerësojnë siç duhet. Ju gjithashtu, mund të raportoni efektet anësore të dyshuara të vaksinave dhe ilaçeve përmes skemës së Kartonit të Verdhë. Ju mund ta bëni këtë në internet duke kërkuar Coronavirus Yellow Card ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card (ju lutem shikoni faqen 2).

Kohët e fundit ka pasur raporte për një gjendje jashtëzakonisht të rrallë që përfshin mpiksjen e gjakut dhe gjakderdhjen e pazakontë pas vaksinimit me AstraZeneca (AZ). Kjo është duke u rishikuar me

kujdes, por faktorët e rrezikut për këtë gjendje nuk janë ende të qartë. Për shkak të rrezikut të lartë të komplikimeve dhe vdekjes nga COVID-19, MHRA, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Agjencia Evropiane e Barnave kanë arritur në përfundimin se bilanci është shumë në favor të vaksinimit.

Nëse përjetoni ndonjë nga të mëposhtmet nga rreth 4 ditë deri në katër javë pas vaksinimit, duhet të kërkoni këshilla mjekësore urgjentisht.

- një dhimbje koke e re, e fortë, e cila nuk ndihmohet nga qetësuesit e zakonshëm ose po përkeqësohet
- një dhimbje koke e pazakontë e cila duket më keq kur shtriheni ose përkuleni, i ose mund të shoqërohet nga
 - shikim jo i qartë, të përziara dhe të vjella
 - vështirësi në të folur
 - dobësi, përgjumje ose kriza
- mavijosje e vogël si me gjilpërë ose gjakderdhje e re, e pashpjegueshme
- gulçim, dhimbje gjoksi, ënjtje në këmbë ose dhimbje të vazhdueshme të barkut

A janë efektet anësore të ndryshme për secilën dozë?

Jo të gjitha vaksinat COVID-19 janë të njëjta - disa kanë tendencë të shkaktojnë më shumë efekte anësore në dozën e parë, të tjerat shkaktojnë më shumë efekte anësore në dozën e dytë. Efektet anësore shumë të zakonshme janë të njëjtat dhe duhet të zgjasin vetëm një ose dy ditë.

A mund ta kap COVID-19 nga vaksinat?

Ju nuk mund të infektoheni me COVID-19 nga vakcina, por është e mundur që të jeni infektuar me COVID-19 dhe të mos e kuptoni se keni simptomat deri pas takimit tuaj të vaksinimit.

Simptomat më të rëndësishme të COVID-19 janë shfaqja e fundit e ndonjë prej të mëposhtmeve:

- një kollë e re e vazhdueshme
- një temperaturë e lartë
- humbja ose ndryshimi i ndjenjës tuaj normale të shijes ose nuhatjes (anosmi).

Megjithëse mund të keni ethe brenda një ose dy ditëve të vaksinimit, nëse keni ndonjë simptomë tjetër të COVID ose ethet zgjatin më shumë, qëndroni në shtëpi dhe organizoni një test.

Kur mund të kthehem në aktivitetet e përditshme?

Ju duhet të jeni në gjendje të rifilloni aktivitete që janë normale për ju, për sa kohë që ndiheni mirë. Nëse krahu juaj është veçanërisht i lënduar, mund ta keni të vështirë ngritjen e peshave të rënda. Nëse ndiheni keq ose shumë i lodhur, duhet të pushoni dhe të shmangni përdorimin e makinerive ose ngarjen e makinës.

Çfarë të bëj më tej?

Nëse kjo është doza juaj e parë, duhet të keni një kartë regjistrimi me takimin tuaj të rradhës ndërmjet 3 dhe 12 javësh. Është e rëndësishme që të keni të dyja dozat e së njëjtës vaksinë për t'ju dhënë mbrojtjen më të mirë.





Mbajeni kartën tuaj të sigurt. Nëse kjo është doza juaj e parë, mos harroni të shkoni në takimin tuaj të rradhës.

Çfarë duhet të bëj nëse nuk jam mirë para takimit tim të ardhshëm?

Nëse nuk jeni mirë, është më mirë të prisni derisa të shëroheni, për të bërë vaksinën tuaj. Ju nuk duhet të shkoni në një takim vaksine nëse jeni vetë-izolues, duke pritur për një test COVID-19, ose brenda 4 javësh pasi të keni një test pozitiv të COVID-19.

A do të më mbrojë vaksina?

Vaksina COVID-19 që keni pasur, është treguar se zvogëlon mundësinë që të vuani nga sëmundja COVID-19. Çdo vaksinë është testuar në më shumë se 20,000 njerëz dhe shumë janë përdorur gjithashtu, në shumë vende të ndryshme.

Mund të duhen disa javë që trupi juaj të krijojë një mbrojtje nga vaksina. Ashtu si të gjitha ilaçet, asnjë vaksinë nuk është plotësisht efektive, kështu që duhet të vazhdoni të merrni masat e rekomanduara për të shmangur infeksionin. Disa njerëz ende mund të marrin COVID-19 pavarësisht se kanë bërë një vaksinë, por kjo duhet të jetë më pak e rëndë.

Çfarë mund të bëj pasi të kem bërë vaksinën?

Vaksina nuk mund t'ju japë infeksion COVID-19 dhe marrja e dozave të rekomanduara do të zvogëlojë mundësinë tuaj për t'u sëmurur rëndë. Ne nuk e dimë se sa do të zvogëlojë rrezikun e transmetimit të virusit. Prandaj është e rëndësishme të vazhdoni të ndiqni udhëzimet aktuale kombëtare.

Për të mbrojtur veten dhe familjen tuaj, miqtë dhe kolegët, DUHET ende të:

- praktikoni distancimin shoqëror
- vini një maskë në fytyrë
- lani duart me kujdes dhe shpesh
- hapni dritaret për të futur ajrin e pastër
- ndiqni udhëzimet aktuale në www.gov.uk/coronavirus

Mbani mend

COVID-19 përhapet përmes spërklave të nxjerra nga hunda ose goja, veçanërisht gjatë të folurit ose kollitjes. Mund të merret gjithashtu, duke prekur sytë, hundën dhe gojën pas kontaktit me objekte dhe sipërfaqe të ndotura.

Vaksinimi, ndihma në mbrojtjen e personave më të prekshëm.

Nëse keni nevojë për më shumë informacion mbi vaksinimin COVID-19, ju lutemi vizitoni: nhs.uk/CoronavirusVaccination

© E drejta e autorit Crown 2021
COV2020307V4AL 1p 12M MAR 2021 (APS)
Shëndeti Publik në Angli numri i portalit: 2021080

Kjo broshurë është gjithashtu e disponueshme në alfabetin brail, si një video BSL, me shkronja të mëdha si një version i lehtë për t'u lexuar, i përkthyer në mbi 23 gjuhë dhe mund të porositet nga www.healthpublications.gov.uk

Ose telefononi **0300 123 1002**